



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
TIRANË

Nr.Regj.Them. 10824/8046/3677/522  
Data e regjistrimit 07.07.2015

Vendimi Nr. 1167  
Data e vendimit 23.03.2018

**V E N D I M**

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga Gjyqtarët :

<b>BARI SHYTI</b>	-	<b>Kryesues</b>
<b>LINDITA SINANAJ</b>	-	<b>Anëtare</b>
<b>AMARILDO LAÇI</b>	-	<b>Anëtar</b>

Asistuar nga sekretare [REDAKTUAR] në Tiranë me datën 23.03.2018 përfundoi shqyrtimin në dhomë këshillimi të çështjes administrative me Nr. 10824/8046/3677/522 Rregj. Them. me palë ndërgjyqëse e objekt si vijon:

**PADITËS:**

**Universiteti Politeknik i Tiranës (U.P.T).**

**TË PADITUR:**

- 1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**
- 2. [REDAKTUAR]**

**OBJEKTI:**

- Shfuqizimin e vendimit nr. 6, datë 20.01.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligji Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”; Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”; Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2884 (80-2015-1467), datë 27.05.2015 ka vendosur:

- *Mospranimin e padisë të paraqitur nga pala paditëse Universiteti Politeknik i Tiranës, pasi padia nuk i plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj.*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse Universiteti Politeknik i Tiranës, me anë të të cilit kërkon ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për gjykim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

**Pala paditëse parashtron këto shkaqe në ankimin e saj:**

- Një pretendim i tillë i gjykatës është i pabazuar dhe ka ardhur si rrjedhojë e një hetimi jo të plotë që gjykata i ka bërë rrethanave të faktit, pasi nëse do të kishte bërë një përlllogaritje të plotë të faktit se kur është komunikuar vendimi i Komisionerit dhe momentin kur padia është dorëzuar në qendrën postare, do të kishte konstatuar se ajo është depozituar në respektim të afatit ligjor.
- Për më tepër që gjykata do të ishte dashur që për të konstatuar këtë fakt, të kishte thirrur në gjykim palën paditëse, e cila me anë të provave shkresore dhe më konkretisht konfirmës postare, si dhe zarfit që vërteton mbërritjen e aktit që kundërshtohet do të mund të shpjegonte gjykatës se kërkesë padia ka qenë brenda afatit të saj ligjor.
- Po kështu, vlen të theksohet se në referim të shkaqeve ligjore të kërkesë padisë, rezulton se ajo përmban edhe shkaqe që lidhen me pavlefshmërinë absolute të aktit, dhe si rrjedhojë padia për konstatimin e pavlefshmërisë absolute është një padi që mund të ngrihet në çdo kohë, pavarësisht afatit.

Ankimi i palës paditëse, pasi është verifikuar nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me kriteret e pranueshmërisë, si legjitimiteti i ankuesit, afati i paraqitjes dhe plotësimi i kushteve formale të kërkuara nga neni 46 i Ligjit Nr. 49/2012, i është njoftuar edhe palëve të paditura, dhe më pas aktet e dosjes bashkë me ankimin, i janë përcjellë Gjykatës Administrative të Apelit për kompetencë funksionale të vendosjes mbi çështjen.

**Gjykata Administrative e Apelit**, si dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari Bari Shyti, analizoi shkaqet e ankimit dhe bisedoi në tërësi çështjen :

**V Ë R E N**

Se vendimi Nr. 2884 (80-2015-1467), datë 27.05.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dhënë në respektim të dispozitave procedurale të Ligjit Nr. 49/2012, lidhur me vendimet jopërfundimtare, për rrjedhojë duhet të lihet në fuqi.

**I. Rrethanat e çështjes**

Pala e paditur [REDACTED] pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, ka paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankesën nr. 94, datë 20.10.2014, ku pretendohet për diskriminim të saj, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e këtij Universiteti.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pasi mori në shqyrtim ankesën e mësipërme, me vendimin nr. 6, datë 20.01.2015 ka vendosur: "1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të Znj. [REDACTED] për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës; 2. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të kandidatëve që janë diplomuar pranë Universiteteve të Rretheve, në Fakultetin e Fizikës dhe zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë të integruar, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës; 3. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme, nga Rektorati dhe Dekanati i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për ndryshimin e kriterit përjashtues në të gjithë njoftimet për punësim për personel akademik, nga data e daljes së këtij vendimi; 4. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e Rektoratit dhe Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për njohjen e të gjithë punonjësve të këtij institucioni, me ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe një kopje e këtij ligji të afishohet në ambientet e brendshme të institucioneve përkatëse; 5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni për këtë vendim, Rektori i UPT-së, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi; 6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2011 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni."

Pala paditëse pasi ka marrë dijëni për vendimin e mësipërm, i është drejtuar palës së paditur me shkresën nr. 144/1 prot, datë 25.02.2015, "Kërkesë për rishimin e vendimit nr. 6, datë 20.01.2015", ku i kërkon që në kushtet kur kriteri i punësimit lidhur me diplomën universitare është një kriter objektiv, i domosdoshëm dhe i lidhur me pozicionin e punës, e për rrjedhojë aspak diskriminues, në kushtet kur znj. [REDACTED] nuk ka shprehur asnjë objeksion lidhur me këtë kriter punësimi por ka pranuar të konkurojë mbi bazën e tij, si dhe në kushtet kur vlerësimi i komisionit ad hoc ka qenë objektiv dhe i bazuar mbi kriteret kualifikuese, kërkojmë nga ana juaj që të rishikoni vendimin nr. 6, datë 20.01.2015.

Pala e paditur nëpërmjet shkresës nr. 273 prot, datë 19.03.2015, "Kthim përgjigje tuajës nr. 144/1, datë 25.02.2015, i bën me dije palës paditëse se kundërshtimet tuaja mbi vendimin nr. 6, datë 25.02.2015, i cili është dhënë pas shqyrtimit të ankesës nr. 94, datë 20.10.2014 të shtetases [REDACTED], mund t'i paraqisni për shqyrtim pranë gjykatës kompetente, pasi vendimet e Komisionerit ankimohen vetëm në rrugë gjyqësore.

Pala paditëse, duke mos qenë dakord me sa më sipër, për rivendosjen e të drejtës së cënuar, me datë 08.05.2015, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në lidhje me vendimin jo përfundimtar për mospranimin e padisë ka arsyetuar ndër të tjera se:**

Referuar nenit 18. të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i cili në pikën 1, gërma d, citon: "Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejtë në gjykatë".

Nga shqyrtimi i provave shkresore të administruara në dosjen gjyqësore rezultoi se pala paditëse ka shkelur afatin 45 ditor, padia është paraqitur në datën 08.05.2015 ndërkohë kur rezulton se dijenia për aktin që kundërshtohet është datë 20.01.2015, pra në tejkalim të këtij afati prekluziv.

Rezultoi se ndaj këtij vendimi pala paditëse ka ushtruar ankim komisionerit dhe ky i fundit në datën 19.03.2015 i ka kthyer përgjigje me shkresën 273 prot, ku i shpjegon se vendimet e komisionerit ankimohen vetëm në rrugë gjyqësore, pra nuk parashikon ligji ankimimin në rrugë administrative. Gjykata konstaton se edhe nqs do të llogaritej afati 45 ditor nga momenti që është kthyer përgjigja nga komisioneri ndaj ankimit të palës paditëse, përsëri konstatohet se është tejkaluar afati i kërkuar nga neni 18, i ligjit 49/2012.

Për sa më lart, gjykata duke analizuar dispozitat ligjore të lartpërmendura, konstaton se padia nuk i plotëson kushtet formale, konkretisht paraqitjen e padisë brenda afatit ligjor 45 ditor. Në këto kushte, duke mbajtur parasysh përcaktimet e bëra në ligj dhe faktet që i përkasin rastit konkret, gjykata vlerëson se padia nuk plotëson kushtet formale që ligji kërkon.

Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", në nenin 39, në pikën 2 citon: "Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave".

Per sa me lart, gjykata duke analizuar dispozitat ligjore të lartpërmendura, konstaton se padia nuk i plotëson kushtet formale, konkretisht paraqitjen e padisë brenda afatit ligjor të posaçëm 45 ditor.

Në funksion të respektimit të dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se kërkesë padia, nuk duhet të merret në shqyrtim për themelin e saj nga gjykata dhe duhet të vendoset mospranim padie.

## **II. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA GJYKATA ADMINISTRATIVE** **E APELIT**

Referuar shkaqeve të parashtruara në ankim nga pala paditëse, rrethanave të çështjes, objektit dhe shkakut ligjor të padisë, si dhe argumenteve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ankimi i palës paditëse, nuk përmban shkaqe që motivojnë cënimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata e Apelit, vëren se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, është i drejtë dhe i bazuar në ligj e prova, lidhur me përfundimin e arritur se padia e paraqitur nga paditësi, nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes si e tillë nuk mund ti nënshtrohet gjykimit. Me të drejtë Gjykata ka vlerësuar se padia e paraqitur nga paditësi Universiteti Politeknik i Tiranës me objekt kundërshtimin e aktit administrativ vendim nr. 6, datë 20.01.2015, i Komisionerit për

Mbrojtjen nga Diskriminimi është parashkruar, për rrjedhojë të drejtave të pretenduara në padi nuk ju garantohet mbrojtje gjyqësore, nëpërmjet kundërshtimit të aktit administrativ. Gjykata e Apelit, si shqyrtoi ankimin e palës paditëse, vlerësoi se ai nuk është i bazuar në ligj e prova.

Ligji Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, në nenin 18 të tij ka disiplinuar afatet e paraqitjes së padisë.

Kështu në pikën 1 të kësaj dispozitë është parashikuar që :

*Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga:*

- a) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;*
- b) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë;*
- c) data e botimit të aktit administrativ, në rastet kur ligji parashikon detyrimin për botimin e aktit;*
- ç) data e marrjes së dijenisë për ndërhyrjen e paligjshme të organit publik mbi të drejtat dhe interesat ligjorë të subjektit, me çdo lloj veprimi që nuk plotëson kushtet dhe formën e aktit administrativ;*
- d) data e mbarimit të afatit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit administrativ, kur akti administrativ që është kërkuar të nxirret ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë;*
- dh) data e mbarimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankimit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit më të lartë administrativ.*

Sikurse është sanksionuar qartësisht në këtë normë materiale të ligjit, afati për të kundërshtuar gjyqësisht një akt apo veprim administrativ është 45 ditë.

Rezulton nga aktet se vendimi objekt kundërshtimi në padi i është njoftuar palës paditëse me shkresën Nr. 77/1 datë 29.01.2015. Ky fakt pranohet nga vetë pala paditëse e cila pasi është njohur me vendimin nr. 6, datë 20.01.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me datë 25.02.2015 ka paraqitur para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi një kërkesë për rishikimin e vendimit në fjalë. Kësaj kërkesë të paditësit i është përgjigjur pala e paditur me shkresën Nr. 273 datë 19.03.2015, sipas të cilës sqarohet pala paditëse se pretendimet lidhur me vendimin e komisionarit mund ti parashtroni në gjykatë, pasi vendimet e komisionarit kundërshtohen drejt për drejt në gjykatë.

Për sas më sipër, provohet plotësisht se pala paditëse prezumohet se ka marrë dijeni për vendimin e komisionarit në datën 25.02.2015, datë në të cilën ka kërkuar po nga komisionari rishikimin e vendimit të tij Nr. 6, datë 20.01.2015. Duke mos pasur një akt tjetër që vërteton datën konkrete të marrjes dijeni për vendimin Nr. 6, datë 20.01.2015, gjykata vlerëson se data e marrjes dijeni, për rrjedhojë edhe fillimi i afatit për të paraqitur padi në gjykatë, do të konsiderohet data kur vetë pala paditëse ka paraqitur kundërshtimet para Komisionerit duke kërkuar rishikimin e vendimit.

Padia objekt i këtij gjykimi është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me datë 07.05.2015.

Sa më sipër është fakt i vërtetuar se padia është paraqitur tej afatit 45 ditor, parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 49/2012, afat ky që i ka filluar palëve të interesuara nga data e vënies në djeni për aktin administrativ. Sikurse theksuam më lart, paditësit ka marrë djeni për vendimin Nr. 6, datë 20.01.2015, me datë 25.02.2015 dhe nga kjo datë kishte të drejtë të kundërshtonte aktin duke paraqitur padi në gjykatë brenda 45 ditëve. Fakti që paditësit ka paraqitur ankim para organit administrative, kur ligji specific në bazë të të cilit është nxjerrë akti nuk e detyron por as e parashikon ankimin administrative, nuk e justifikon paditësin në paraqitjen e padisë tej afatit 45 ditor. Duke mos parashikuar Ligji ankim administrative, dhe marrjen e një vendimit nga një organ tjetër administrative para se ta paraqitet padi në gjykatë, referuar gërmës “b” të pikës 1, të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012, afati i paraqitjes së padisë për palën paditëse, për të kundërshtuar vendimin Nr. 6, datë 20.01.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka filluar nga data e njoftimit të aktit duke marrë si të tillë datën 25.02.2015.

Në pikën 7 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 është parashikuar që: *Afatet e mësipërme janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë. Këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht.* Referuar kësaj normë të ligjit, me të drejtë gjykata ka konstatuar se paditësit ka humbur të drejtën e padisë për të kundërshtuar aktin administrativ me padi në gjykatë. Këtë fakt gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar kryesisht, gjatë kontrollit të kushteve formale të padisë, parashikuar në Kreun IV të Ligjit Nr. 49/2012.

Gjykata e gjen të pabazuara pretendimin e paditësit, sipas të cilit afati i parashkrimit nuk është plotësuar. Pala paditëse nuk paraqet në ankimin e saj asnjë fakt që provon pretendimin se padia është paraqitur në afat. Përmenden në ankim dëftesa postare, por nuk referohet në asnjë datë konkrete kur paditësi është vënë në djeni të vendimit objekt kundërshtimi në padi. Përkundrazi nga aktet e dosjes, vetë pala paditëse pranon nëpërmjet shkresës që i ka dërguar komisionarit me datën 25.02.2015, se është njohur me vendimin Nr. 6, datë 20.01.2015, komunikuar më shkresën Nr. 77/1 datë 29.01.2015.

Nuk rezulton nga aktet që të jetë vërtetuar ndonje rrethanë nga ato që parashikon neni 131 i K.Civil për ndërprerjen e ecjes së afatit të parashkrimit të padisë dhe fillimit të ndonjë afati të ri parashkrimi.

Padia si instrument procedural për mbrojtje e të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjekteve të së drejtës në fushën e së drejtës publike, për tu marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative duhet të plotësoje disa kushte formale.

Kushtet formale të padisë janë parashikuar nenet 15 – 19 të Kreut IV, me titull *SUBJEKTET DHE KUSHTET FORMALE TË PADISË*, të ligjit nr. 49/2012 “Per gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative...”.

Në kushtet formale të padisë përfshihen edhe kërkesat e parashikuara në nenin 18 të ligjit në fjalë, dhe që kanë të bëjnë me afatin e paraqitjes së padisë për kundërshtimin e akteve apo

veprimeve administrative. Kushtin për paraqitjen e padisë brenda afatit të parashikuar në këtë dispozitë, apo në afatet e parashikuara në dispozitat e ligjit të posaçëm, ligji Nr. 49/2012 e ka sistemuar në kapitullin e kushteve formale të padisë. Mosplotësimi i këtij kushti sjell si pasojë mosshqyrtimin në themel të pretendimeve të palëve, dhe dhënien e një vendimi jo përfundimtar siç parashikohet në nenin 39/2 të Ligjit Nr. 49/2012.

Për të gjitha sa më sipër, ky kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së Shkallës së parë është i dhënë në interpretim e zbatim të drejtë të ligjit për rrjedhojë ai duhet të lihet në fuqi pasi nuk ka asnjë shkak nga ato që ka parashtruar paditësi në ankim, apo shkaqe që ky kolegji i vlerësoi kryesisht duke pasur parasysh këtu të drejtën që garanton rendi juridik, për akses në gjykatë, që të bëjë të cënueshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë kcshillimi, bazuar në nenet 49 e 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, i ndryshuar

### **VENDOSI**

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 2884 (80-2015-1467), datë 27.05.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot me datë 23.03.2018.

**ANËTAR**  
**Amarildo LAÇI**  
(d.v)

**ANËTARE**  
**Lindita SINANAJ**  
(d.v)

**KRYESUES**  
**Bari SHYTI**  
(d.v)

**Vërtetohet njësia me origjinalin**

*Kancelari*  
*Leonard Shyti*  
*Shyti*

